



Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.9/2017, datë 02.08.2017), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 57-të, të mbajtur më 17 korrik 2018, mori:

V E N D I M

I. Tërhiqet akreditimi i programeve të studimit të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" :

- Ndërmarrësi dhe Zhvillim Ekonomik Lokal, MA, 120 ECTS;
- Ekonomiks, PhD, 180 ECTS.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Bazuar në Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (tash e tutje UA për Akreditim), neni 21 dhe 26, pika 5.3.4, Agjencisë së Kosovës për Akreditim (tash e tutje AKA) me datë 23 maj 2018 ka kërkuar nga të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë (tash e tutje IAL) që ti dorëzojnë listat e stafit akademik për secilin program të studimit. Në afatin e përcaktuar nga AKA, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti Ekonomik ka dorëzuar listat për programet e studimit.

Bazuar në të dhënat e prezantuara nga ky fakultet, për programin e studimit Ndërmarrësi dhe Zhvillim Ekonomik Lokal, MA, 120 ECTS, dhe Ekonomiks, PhD, 180 ECTS, (sipas kërkesës së AKA-së datë 23.05.2018) konfirmohet se për këto dy programe nuk kanë asnjë staf akademik si bartës të programeve të cekura me lartë.

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 kërkohet që: "Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë që për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD apo titull të barasvlershëm artistik nga fusha e programit të studimeve". Pra siç mund të shihet nga sa u tha me sipër, kërkohet që për

çdo 60 ECTS, IAL duhet të ketë një person në marrëdhënie të rregullt të punës me gradën shkencore PhD dhe të jetë i fushës së programit të studimit.

Me këtë rast KSHC, bazuar në nenin 21 të UA për Akreditim, në mungesë të stafit akademik për këto dy programe të studimit, vendosi që ta tërheq / revokoi akreditimin e këtyre programeve. Këto programe ishin akredituar me vendim të KSHC-së, Nr: 828/15 data: 31.08.2015.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (tash e tutje LPPA) nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti Ekonomik;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

G. Luboteni

Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

